



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr 12 - 010/04 - 14931 , dt. 30. 04. 2020

Duke u bazuar në nenin 11,12, dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008, 04 qershor 2008), neni 34, pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 24 dhe 24 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 4 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, të datës 28 tetor 2010, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.04.2020 , miratoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen, në parcelën 743/1, në zonën kadastrale Drenas

Neni 1

Më këtë Vendim formohet Komisioni për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen, në parcelën 743/1, në zonën kadastrale në Drenas në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, dhe dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës:

1. Granit Karaqica -anëtar nga ekzekutivi
2. Fadil Tahiri -anëtar nga ekzekutivi
3. Granit Hasanaj -anëtar nga ekzekutivi
4. Malsore Cakiq - anëtar nga kuvendi
5. Burim Bujupi -anëtar nga kuvendi

Neni 2

Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e të gjitha banesave private që ndodhen në pronën komunale në parcelën 743/1, e të cilat në bazë të m² ka mundësi këmbimi me pronën komunale, në të njëjtën kohë të vlerësohen banesat komunale që duhet të këmben me banesat private.

Neni 3

Komisioni po ashtu ka për detyrë që të vlerësoj që cilat banesa private që ndodhen në pronën komunale në parcelën 743/1, në bazë të m² nuk mund të këmben, e që do të duhet të vazhdohet sipas procedurave të shpronësimit.

Neni 4

Ky këmbim, respektivisht shpronësim, ka për qëllimin lirimin e pronës komunale në parcelën 743/1, në zonën kadastrale në Drenas, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshme, duke siguruar edhe qëllimin për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Neni 5

Pas aprovimit të këtij vendimi, komisioni brenda një afati të arsyeshëm duhet të vie me propozime konkrete pranë kuvendit të komunës së Drenasit.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .

 Kryetari i Kuvendit të Komunës
Minot Halilaj